

VENDIM
Nr. 1146, datë 24.12.2020

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË
PRIVATIZIMIT PËR PASURINË NR. 109, ME EMËRTIM “SHA RIPARIM
ARTILIERIE”, E PËRBËRË NGA DISA SIPËRFAQE, TRUALL FUNKSIONAL DHE
OBJEKTE, ME VENDNDODHJE NË BRAR, TIRANË, ME SIPËRFAQE TË
PËRGJITHSHME 43 169 m², DHËNË ME KONTRATË ME ÇMIMIN 1
EURO/KONTRATA FONDACIONIT “FUNDJAVË NDRYSHE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros të këtyre ndërmarrjeve”, të miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008; të pikës 32, kreu III, të vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për fillimin e procedurave të privatizimit për pasurinë nr. 109, me emërtim “Sh.a. riparim artilerie”, e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m², dhënë me qira me kontratën me çmimin 1 euro/kontrata dhe miratuar me vendimin nr. 113, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe fondacionit ‘Fundjavë ndryshe’, si qiramarrës, për pasurinë nr. 109, me emërtim ‘Sh.a. riparim artilerie’, e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m²”.

2. Me nënshkrimin e kontratës së shitjes së pasurive shtetërore të sipërcituara, vendimi nr. 113, datë 13.3.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë, me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si qiradhënëse, dhe Fondacionit ‘Fundjavë ndryshe’, si qiramarrës, për pasurinë nr. 109, me emërtim ‘Sh.a. riparim artilerie’, e përbërë nga disa sipërfaqe, truall funksional dhe objekte, me vendndodhje në Brar, Tiranë, me sipërfaqe të përgjithshme 43 169 m²”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe